



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 71, Datë 26.03.2018**

**MBI**

**HEQJEN E LICENCËS NR. 124, SERIA T11P SHOQËRISË “HEC DUNICË” SH.P.K,  
PËR TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”, MIRATUAR ME VENDIMIN E  
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE NR. 28, DATË 10.03.2011.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, gërmat “ç” ; “d” dhe “dh” të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë të Elektrike”, nenit 18 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, nenit 5, gërmat “ç”, “d” dhe “dh”, neni 9 të “Rregullores për Procedurat e Heqjes së Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror” miratuar me vendimin e bordit nr. 54, datë 18.04.2017, pika 5.1, gërmat “d” dhe “dh” të kushteve të “Licencës së Tregtimit të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 97, datë 17.06.2016 si dhe nenit 9 pika 9.3 të “Rregullores për miratimin dhe përcaktimin e pagesave rregullatore”, miratuar me vendimin e bordit me nr. 190, datë 23.11.2017; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 26.03.2018, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë “Hec-Dunicë” sh.p.k. me nr.124, Seria T11P, miratuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE nr. 28, datë 10.03.2011,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria tregtare “Hec–Dunicë” sh.p.k, ka paraqitur në ERE kërkesën me nr. 08 Prot, datë 19.01.2018, protokolluar me tonën nr. 104, datë 23.01.2018), për heqjen licencës së Tregtimit të Energjisë Elektrike, si dhe heqjen e pagesës së rregullimit për vitin 2017.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 37, datë 09.02.2016, ka filluar procedurën për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë “Hec-Dunicë” sh.p.k, me nr. 123,

Seria PV11K, miratuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE nr. 27, datë 10.03.2011.

- Në vijim të këtij vendimi ERE me shkresën nr. 104/3 Prot, datë 23.02.2018, ka njoftuar subjektin “Hec-Dunicë” dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimarrjen e bordit dhe pas përfundimit të afatit ligjor të pritjes së komenteve nga palët, nuk ka patur asnjë reagim.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën me nr. 46/49 Prot, datë 26.04.2017, drejtuar shoqërisë “Hec-Dunicë“ sh.p.k. dhe për dijeni Agjensisë Kombëtare të Brimeve Natyrore dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, ka njoftuar për zgjidhjen e Kontratës së Konçensionit me Nr. 2059 Rep, dhe Nr. 248/1 Kol, datë 16.06.2009 për ndërtimin e e hidrocentraleve në pellgun e lumit Dunicë , Pogradec. Kjo kontratë është lidhur midis bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Vortek” sh.p.k dhe “By Best Duty Free” sh.p.k dhe Autoritetit Shtetëror ish – Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
- Subjekti referuar shkresave të komunikimit në vijim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 46/49 Prot, datë 26.04.2017 dhe shkresën me nr. 46/51 Prot, datë 14.06.2017, rezulton se është në kushtet e paaftësisë për të vazhduar aktivitetin e tregtimit dhe për rrjedhojë kërkon heqjen e licencës.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 208, datë 18.12.2017, ka përcaktuar Pagesat e Rregullimit për vitin 2017. Bashkëlidhur liststës për subjektet e licencuara në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike, rezulton edhe subjekti “Hec-Dunicë”sh.p.k. me nr. 16 rendor, dhe për vitin 2017 i përkon pagesa rregullatore, në shumën 40 000 lekë.
- Referuar rrethanave sipërcituar, subjekti “HEC DUNICË” rezulton në kushtet e paaftësisë për të vazhduar aktivitetin dhe ka kërkuar heqjen e licencës dhe e pagesës së rregullimit për vitin 2017, bazuar kjo në pikën 1 gërma “ç” të nenit 42 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në nenin 9 pika 9.3 të “Rregullores per Miratimin dhe Përcaktimin e Pagesave Regullatore”, miratuar me vendimin bordit të ERE me nr. 190, datë 23.11.2017.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. T'i heqë licencën Nr. 124, Seria T11P, shoqërisë "Hec-Dunicë" sh.p.k, për tregtimin të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 28, datë 10.03.2011.
2. Miratimin e kërkesës së shoqërisë "Hec-Dunicë" sh.p.k, për heqjen e pagesës së rregullimit për vitin 2017, në shumën 40 000 lekë, për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
3. Drejtoria e Licencimit dhe monitorimit të tregut, të njoftojë shoqërinë "Hec-Dunicë" sh.p.k dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare